

# RELACION TEKNIK

**“ NDËRTIM I RRJETIT KRYESOR FURNIZIMI ME UJË I  
FSHATRAVE TË NJËSISË ADMINISTRATIVE MAQELLARË DHE  
RRJETI SHPËRNDARËS, FAZA II ”**

**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DIBËR SH.A  
FAZA PROJEKT-ZBATIM**



**VITI 2024**

**RELACION TEKNIK:**

**STUDIM PROJEKTIM NDËRTIM I RRJETIT KRYESOR FURNIZIMI ME UJË I FSHATRAVE TË NJËSISË ADMINISTRATIVE MAQELLARË DHE RRJETI SHPËRNDARËS, FAZA II**

**1. QËLLIMI**

Ky projekt zbatimi konsiston në furnizimin me uje te disa fshatrave pjese e Njesise Administrative Maqellare.

Ky studim eshte ne vijëmësi të projektit : « NDERTIM RRJET KRYESOR FURNIZIMI ME UJE I FSHATRAVE TË NJËSISË ADMINISTRATIVE MAQELLARE, DHE RRJET SHPËRNDARËS, FAZA II » .

Sipas të dhënave të detyrës së projektimit, imazhi satelitor si me poshte tregon planvendosjen e objektit :



Zona e studimit eshte pjese e Njesine Administrative Maqellare, dhe perfshin fshatrat e meposhtem :

MAQELLARË
BLLATË E POSHTME
BLLATË E EPËRME
BURIM
ÇERNENË
FUSHË E VOGËL (KURBEG)
KOVASHICË
MAJTARË

POTGORCË
VOJNIKË

Projekti synon furnizimin me uje te ketyre fshatrave permes burimeve natyrore te ujit te pijshem me vendodhje ne zonën e Kerçishtit si dhe shfrytezimin e burimeve te reja natyrore, permes shfrytezimit te burimit te "Krasta e Kuqe".

Per studimin e burimit te ri "Krasta e Kuqe", me porosi Shoqerine Rajonale te Ujesjelles Kanalizime Dibër eshte hartuar studimi hidrogeologjik me titull : RAPORT HIDROGJEOLOGJIK MBI TË DHËNAT E BURIMIT TË KRASTËS SË KUQE PËR FURNIZIM ME UJË SHITESË TË NJËSISË ADMINISTRATIVE MAQELLARË, BASHKIA DIBER.



*Foto Nr. 1 Relievi i zones së burimit*

Fshatrat te cilat jane pjese e ketij studimi aktualisht kane nje rrjet shperndares te ndertuar gjate vitit 2005. Ne ate periudhe ky ujesjelles eshte vendosur perkohesisht ne funksion, duke u abandonuar me pas si pasoje e kosos se larte per shfrytezim (ujesjellesi ishte i pajisur me nje impiant ngritje mekanike, dhe zbutje ujit).

Projektuesi ka kryer rikonjiicione ne vend, ku te jene evidentuar te gjitha problematikat e veprave te ketij ujesjellesi, duke synuar me pas marrjen e masave te nevojshme per vendosjen ne funksion si dhe shfrytezimin e ketij ujesjellesi.

Me poshte ne kete relacion jane argumentuar te gjitha gjetjet teknike si dhe masat e marra.

## 2. POZITA GJEOGRAFIKE

Komuna e Maqellares eshte njesi administrative me e madhe ne Qarkun Dibres dhe nder 10 njesite administrative me te medha ne vend. Ajo kufizohet ne veri me Nj.Administrative te Melanit, ne lindje dhe ne jug me Republiken e Maqedonise, ne perendim me Nj.Administrative te Shupenzes dhe Nj.Administrative te Gjorices.Ne Perendim pershkohet nga lumi Drini i Zi.Maqellara ka relief fushor, kodrinor dhe malor, kuota me e ulet e relievit ndodhet ne Gradec me lartesi rreth 410 m mbi nivel te detit, ndersa kuotat me te larta jane Maja e Kerçinit me lartesi 2343 m dhe Maja e Velivarit 2374 m.Maqellara eshte nje nyje lidhese mes Dibres se Madhe dhe rrethit Diber, mes Dibres se Madhe dhe Tiranës, Durresit dhe gjithë Shqiperise.Ka burime te shumta natyrore.Klima, ne stinen e veres eshte e nxehte dhe e thate, ndersa dimri, eshte i ashper, me rreshje debore e lageshtire. Ne arterien kryesore te kesaj rruge Tirane – Peshkopi dhe Bllate (dogana) – Peshkopi e cila siguron nje komunikim me te gjithë rrethin e Dibres dhe Shqiperine ne aksin rrugor Bllate – Maqellare – Tirane. Ka nje siperfaqe te pergjithshme 87.3 km<sup>2</sup>. Popullsia arrin ne 14000 banore e shperndare ne 22 fshatra: Maqellare, Burim, Potgorce, Çernene, Vojnike, Fushe e Vogel, Kovashice, Gradec, Dovolani, Erebare, Herbel, Grazhdan, Pesjake, Popinare, Katund i Vogel, Pocest, Kerçisht i Eper, Kerçisht i Poshtem, Klllobçisht, Bllate e Eper, Bllate e Poshtme, Majtare.

## 3. KUSHTET NATYRORE



Rrethi i Dibrës ka një ndërtim të larmishëm gjeologjik molasat e plio-kuarternarit. Flishiri dhe formacione të tjera si magmatik dhe depozitime të kuaternarit në afërsi të luginës. Vendin kryesor e zënë molasat e plio-kuarternarit, por gjejmë edhe rreshpete paleozoitike si dhe gëlqeroret e mesozoitike që janë edhe formacionet më të vjetra të vendit tonë. Kurse shkëmbinjtë efuzivë dhe fliшет ndërtojnë skajin me jugor të vargut të Korabit gjejmë edhe formacione karbonatike dhe ultra-bazike. Këto formacione kanë bërë që ky rajon të ketë pasuri të shumta si bakër në kodrat e Tominit, mermer në Muhurr si edhe pasuri të shumta në inerte si argjila.

tokat prodhuese. Ky rajon ka mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit, me peizazhe piktoreske që ofron edhe parku kombëtar i Lurës pyjet e shumta dhe liqenet e Lures

## 4. KLIMA

Rrethi i Dibrës bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare malore dhe atë mesdhetare para-malore meqënëse është pjesë e pellgjeve të lumenjve të Drinit. Dallohet për ndryshime të dukshme nga një sektor në një tjetër sidomos në drejtimin vertikal.Në formimin e kësaj klime kanë ndikuar faktorë si:lartesia dhe relievi i territorit,ndikimi i

madh i klimës kontinentale nëpërmjet erave që vijne nga grykat dhe qafat nga brendësia e ballkanit. si rezultat kjo klimë dallohet për klimë të ashpër, dimër të gjatë dhe reshje të mëdha të dëbores dhe verë të freskët por pa reshje. Temperatura mesatare shkon nga 6 °C në malin e Korabit në 11 °C në afërsi të luginës. Po ta krahasojmë me temperaturën mesatare të vendit tone ajo leviz nga 4°C-8°C kuptohet që shkak kryesor është lartësia mbi nivel të detit dhe pozicioni i saj lindor që kushtëzon një ndikim nga brendësia e ballkanit. Në periudhën prill-shtator temperatura mesatare është 16°C në afërsi të qytetit. Për muajin korrik temperatura mesatare shkon nga 7 °C në pjesë të larta dhe 16 °C në afërsi të luginës. Muaji janar është muaji më i ftohtë i vitit ku mesatarja shkon nga 0°C në -3°C. Amplituda e temperaturës vjetore merr vlera jo të vogla që shkojnë rreth 17°C-18°C. Kurse amplituda ditore shkon deri 10-15°C temperatura maksimale e zonës është regjistruar në korrik të 1996 në qytet 39.5°C kurse ajo minimale është regjistruar në 1959 kur ka arritur -20°C amplituda midis vlerave është relativisht jo e vogël që shkon 60°C. Data mesatare e fillimit të ngricave është 1 nëntori dhe data mesatare është 15 marsi. Numri mesatar i ditëve me ngrica shkon 136 ditë kurse po ta krahasojmë me zonat perendimore të vendit ajo është 40-45 ditë. Numri maksimal shkon 166 -190 në zonat më malore të kesaj zone që kemi marrë në studim. Për sa i përket sasise së rreshjeve zona futet në zonat nën masataren së vendit. Kjo vlerë shkon nga 900 mm (në qarrishte) ky ndryshim lidhet me deporimin e erave të ftohta e të thata. Pjesa më e madhe e tyre është e përqendruar në pjesën e ftohtë të vitit, 90%. Kurse në pjesën e ngrohtë bien rreth 10-15%, Muaji më i lagët është nëntori me 12% të rreshjeve afro 225 mm, kurse muaji më me pak reshje është korriku me 3.6% ose 46 mm. Maksimumi i reshjeve në 24 ore ka qënë 127 mm. Për reshjet e dëbores mund të themi se fillojnë mesatarisht me 1 nëntor dhe data e mbarimit është 20 mars. Numri mesatar i ditëve me borë shkon 38 ditë dhe krijon një shtresë mesatare prej 30-35 cm. Shtresa maksimale shkon 1.5m në shpata të malit. Për sa i përket dukurive negative të klimës mund të themi se ajo ka karakter kapriçoz, pra ajo ka diktuar edhe vendosjen dhe mënyrën e ndërtimeve në këtë reth. Po ashtu kjo klimë nuk lejon kultivimin e të gjitha llojeve të bimëve dhe me dukuri si: ngrica të gjata dhe të vona, dorë të hërshme. Rreshjet e mëdha të borës dhe të breshërit, jo pak herë kanë shkatërruar prodhimet bujqësore dhe i kanë dhënë drejtim të gabuar zhvillimit ekonomik, por kjo klimë ka edhe favore të veta pasi lejon zhvillimin e disa llojeve të turizmit, si edhe të disa sektorëve të tjerë të ekonomisë.




## 5. GJENDJA E FURNIZIMIT ME UJË TE FSHATRAVE

Njësia Administrative Maqellarë ndodhet ne Luginën e Drini i Zi dhe ka në përbërje të saj 22 fshatra. Ndodhet në një lartësi rreth 700 metra mbi nivelin e detit.Ndodhet në jug të Rrethit Dibër. Kuizohet në Veri me Komunën Melan, në Lindje me Republikën

e Maqedonisë Komuna e Rostushë-Mavrovës, në Jug me Dibrën e Madhe, në Perëndim me Komunitat Shupenzë dhe Gjoricë. Në pjesën perëndimore në të gjithë gjatësinë e saj e përshkon lumi Drin ku pika më e ulët është në Gradec 440 m mbi nivelin e detit, ndërsa në pjesë lindore nga vargmali i Deshatit me dy maja të larta si Mali i Velivarit 2371 m dhe Mali i Kërçinit 2343 m.

Ujesjellesi I Maqellarës I ndertuar ne vitin 2005, aktualisht eshte jashte funksioni. Banoret e te gjithë fshatrave kane zgjidhur problematiken e furnizimit me uje permes ndertimit te pus-shpimeve duke shfrytëzuar pozicionin topografik prane lumit Drin. Megjithate pas rikonjicioneve ne zone, shume banore shprehnin ankesa per cilesine e ujit te pijshem qe ata mund te sigurojne permes ketyre pus shpimeve.

Me qellim vlersimin e ujesjellesit, jemi njohur me project zbatimin te zbatuar ne vitin 2005. Me poshte skema operationale e ketij ujesjellesi:




Nga verifikimet ne vend, dhe pas bisedave me ish punonjes te ketij ujesjellesi na rezulton se project zbatimi ka mosperputhje me verifikimet e kryera. Persa me sipër, pamvaresisht se nuk ndikojne ne zgjidhjen e paraqitur, jemi te detyruar te citojme burimin e informacionit.

Ujesjellesi ekzistues perbehej nga nje sere rezervuaresh beton-arme me volume te

ndryshme, te pajisur me puseta manovrimi, si dhe rrjeti shperndares. Veprat e azhornuara I listojme me poshte:

### 1- Rezervuari V=1000m<sup>3</sup> ne Maqellarë



Rezervuari I vendosur ne kuote tabani +681.24. Rezervuari paraqitet ne kushtet strukture te mira, pervec disa nderhyrjeve te cilat jane te domosdoshme per shfrytezimin e vepres:

- Ndertim rrethimit te rezervuarit
- Pastrim nga mbeturinat ne brendesi te rezervuarit
- Rehabilitim dhomes se rojes
- Furnizimi me energji elektrike
- Pastrim pusetave te manovrimit
- Zevendesim rakorderive ne pusetat e manovrimit
- Rehabilitimin e kaperderdhesave per te dy seksionet e rezervuarit

Me poshte foto te gjendjes ekzistuese te objektit





*Detaj puseta manovrimi ne hyrje te rezervuarit*





*Detaj rrethimit*



*Detaj dhoma e rojes per tu rehabilituar*



*Detaj dhoma e manovrimit*




## 2- Rezervuaret “Stacioni i Pompave”

Ne ambientet e stacionit te pompave (aktualisht jashte funksionit) gjenden disa rezervuare me volume te ndryshme te cilat kane sherbyer si me poshte:

- Rezervuar  $V=100m^3$  furnizon me uje rezervuaret e fshatrave Kovashice, Vojnik dhe Fush e Vogel.
- Rezervuar  $V=2x50m^3$  furnizon me uje rrjetin shperndares fshati Çernen
- Rezervuar  $V=2x100m^3$  furnizon me uje rrjetin shperndares fshati Burim
- Rezervuar  $V=1x100m^3$  furnizon me uje rezervuarin Podgorc
- Rezervuar  $V=50m^3$  I cili ka pas grumbulluar prurjen nga pus-shpimet ne Bllate dhe me pas sherbente per dergimin e ujit ne impiantin e zbutjes. Ky rezervuar nuk do eshte I lidhur me rrjetin shperndares te asnje fshati, ndaj nuk do te jete pjese e skemes se re te ujesjellesit.

Eshte per tu theksuar se nga informacioni I marr ne vend, nga ish punonjes qe kane sherbyer ne kete ujesjelles, destinacioni I ketyre rezervuareve nuk perputhet teresisht me ate te dhene ne projektin e zbatimit. Ne listen e mesiperme kemi listuar funksionin e cdo rezervuari sipas informacionit te marr ne vend. Megjithate mbetet detyre e sipermarresit te punimeve qe te identifikojte, pasi te behen provat per kete ujesjelles, perkatesine e sakte te çdo rezervuari. Kuota e tabanit te ujit te gjithe rezervuareve eshte pranuar +599.50m. Me poshte vendodhja:





#### Planvendosje e objektit

Pas rikonjicioneve ne vend kemi gjykuar mbi masat qe duhet te merren me qellim vendosjen ne funksion te tyre:

- Ndertim rrethimit te rezervuareve
- Pastrim nga mbeturinat ne brendesi te cdo rezervuarit
- Ndertim dhome vend roje
- Vendosje kapak pusetash
- Punime ndricimi te jashtem
- Furnizimi me energji elektrike
- Pastrim pusetave te manovrimit
- Zevendesim rakorderive ne pusetat e manovrimit
- Rehabilitimin e kaperderdhesave per seksionet e rezervuarit

Me poshte fotot te objektit:



*Foto puseta manovrimi ne hyrje te rezervuareve*



*Mungese kapaku ne pusetat e manovrimit*



Foto ditare te cdo seksion rezervuari




Foto te kushteve te rrethimit ekzistues

### 3- Rezervuaret “Bllate e Poshtme, Bllate e Siperme, Majtare”

Ne kuote toke +663m jane te vendosur 3 rezervuare me volume te ndryshme. Rezervuaret paraqiten ne kushte strukturore te mira. Perketesisht :

- Rezervuar  $V=2 \times 100 \text{m}^3$  furnizon me uje rrjetin shperndares Majtare
- Rezervuar  $V=2 \times 50 \text{m}^3$  furnizon me uje rrjetin shperndares Bllata e Poshtme
- Rezervuar  $V=2 \times 50 \text{m}^3$  furnizon me uje rrjetin shperndares Bllata e Siperme

Pozicionimi I rezervuareve:





Pas rikonjicioneve ne vend kemi gjykuar mbi masat qe duhet te merren me qellim vendosjen ne funksion te tyre:

- Ndertim rrethimit te rezervuareve
- Pastrim nga mbeturinat ne brendesi te cdo rezervuarit
- Ndertim dhome vend roje
- Vendosje kapak pusetash
- Punime ndricimi te jashtem
- Furnizimi me energji elektrike
- Pastrim pusetave te manovrimit
- Zevendesim rakorderive ne pusetat e manovrimit
- Rehabilitimin e kaperderdhesave per seksionet e rezervuarit

Me poshte fotot te objektit:



Pamje ne brendesi te rezervuarit



Detaj pusete manovrimi ne dalje te rezervuareve (mungese rakorderive)




Pamje e rezervuareve

#### 4- Rezervuaret “Vojnik, Kovashice, Fushe e Vogel”

Rezervuaret te vendosur ne kuote +560m jane me volume te ndryshme. Rezervuaret paraqiten ne kushte strukture te mira. Perkatesisht:

- Rezervuar  $V=2 \times 100 \text{m}^3$  furnizon me uje rrjetin shperndares Kovashice
- Rezervuar  $V=2 \times 50 \text{m}^3$  furnizon me uje rrjetin shperndares Fush e Vogel
- Rezervuar  $V=2 \times 100 \text{m}^3$  furnizon me uje rrjetin shperndares Vojnike

Pozicionimi I rezervuareve



Pas rikonjicioneve ne vend kemi gjykuar mbi masat qe duhet te merren me qellim vendosjen ne funksion te tyre:

- Ndertim rrethimit te rezervuareve
- Pastrim nga mbeturinat ne brendesi te cdo rezervuarit
- Ndertim dhome vend roje
- Vendosje kapak pusetash
- Punime ndricimi te jashtem
- Furnizimi me energji elektrike
- Pastrim pusetave te manovrimit
- Zevendesim rakorderive ne pusetat e manovrimit
- Rehabilitimin e kaperderdhesave per seksionet e rezervuarit

Me poshte fotot te objektit:



Detaj pusete manovrimi ne dalje te rezervuareve (mungese rakorderive)






Detaj dritareve per cdo seksion rezervuari

### 5- Rezervuar Podgorc

Rezervuari ne kuote +503.91m me volum  $V=2 \times 50 \text{m}^3$  sherben per furnizimin me uje te fshatit Podgorc. Planvendosja e objektit:



Pas rikonjiconeve ne vend kemi gjykuar mbi masat qe duhet te merren me qellim

vendosjen ne funksion te tyre:

- Ndertim rrethimit te rezervuarit
- Pastrim nga mbeturinat ne brendesi te cdo rezervuarit
- Ndertim dhome vend roje
- Vendosje kapak pusetash
- Punime ndricimi te jashtem
- Furnizimi me energji elektrike
- Pastrim pusetave te manovrimit
- Zevendesim rakorderive ne pusetat e manovrimit
- Rehabilitimin e kaperderdhesave per seksionet e rezervuarit

Me poshte fotot te objektit:



Pamje te pusetave ekzistuese

## 5.1 GJENDJA EKZISTUESE E RRJETIT SHPËRNDARËS

Detyra projektimit për këtë objekt, ka specifikuar se rrjeti shpërndarës është ekzistues, dhe nuk do të trajtohet në projekt. Megjithatë disa azhurnime janë realizuar për të gjykuar paraprakisht mbi problematika të mundshme për vendosjen në funksion të këtij rrjeti.

Nga informacioni dhënë nga banoret e zonës, rezulton se në përgjithësi puseta e rrjetit shpërndarës, janë në kushte të mira, megjithatë sipas rastit ato do të duhet të pastrohen pasi rezultojnë të përbytura ose me prani inertesh. Duke gjykuar mbi faktin se saracineskat e manovrimit nuk janë përdorur dhe as mirembajtur prej më shumë se 10 vjetësh, kemi parashikuar trajtimin e tyre ose zëvendësimin sipas rastit. Nga projekti I azhurnuar numri I pusetave për të gjithë rrjetin shpërndarës rezulton të jetë 102. Projekti I azhurnuar nuk jep informacion të saktë mbi diametrat e tubacioneve në rrjetin shpërndarës, megjithatë kemi gjykuar diametrat me të përdorshëm Dj-63,75,90,110,125,160,225 etj. Gjatesia totale e rrjetit shpërndarës sipas projektit rezulton të jetë mbi 22km.

Sipas informacionit, si dhe kushteve të detyrës së projektimit është parashikuar instalimi I ujëmatesave për të gjithë abonentet. Me poshtë disa fotot të rrjetit shpërndarës të realizuara në vend:



Foto të pusetave plastike pranë një basene në fshatin Majtare





Pamje e ujematesit dhe saracineskes ne brendesi te pusetes



Foto pusete manovrimi fshati Majtare (e permbytur)



Foto pusete manovrimi fshati Burim mbushur me mbeturina






Foto pune per zbulimin e nje pusete ujematesi ne fshatin Burim



### 6. ZGJIDHJA TEKNIKE E PROPOZUAR

Sic u permend edhe me siper, projekti ka per qellim furnizimin me uje te popullsise qe banon ne fshatrat e Njesise Administrative Maqellare. Projekti parashikon vendosjen ne funksion te ujesjellesit ekzistues. Burimet e furnizimit me uje qe do te shfrytëzohen per kete projekt jane burimet natyrore te Kercishtit te cilat aktualisht jane ne faze zbatimi sipas projektit: « NDERTIM RRJET KRYESOR FURNIZIMI ME UJË I FSHATRAVE TË NJËSISË ADMINISTRATIVE MAQELLARE, DHE RRJET SHPËRNDARËS, FAZA II ». Gjithashtu shfrytëzimi i burimeve ne Krasten e Kuqe. Skema hidraulike e propozuar per vendosjen ne funksion te ketij ujesjellesi do te jete si me poshte :



Punimet inxhinierike per kete objekt jane si me poshte:

- Kaptazhin e burimeve "Krasta e Kuqe"
- Tubacionin me presion per percjelljen e prurjes nga kaptazhi deri ne Rezervuarin  $V=1000m^3$  ne Maqellare
- Tubacion me presion per percjelljen e prurjes se burimeve Kërçisht per nje gjatesi  $L=1383m$  deri ne nje Pusete Shuarje presioni te vendosur ne kuote  $+670.13m$  e cila do te sherbeje edhe si partitor per ndarjen e prurjes per secilin rezervuar ne baze te vlerave te prurjes maksimale ditore
- Ndertimin e nje tubacioni me presion per percjellen e prurjes se burimeve Kërçisht nga puseta e Shuarjes se presionit deri ne rezervuaret te "Stacioni I Pompave". Tubacioni me gjatesi  $L=2642m$
- Punime rehabilitimi rezervuareve, rrjetit shperndares sipas pershkrimtit te dhene ne kapitujt e mesiperm.


## 7. KAPTAZHI I BURIMEVE

Burimet ujore jane dalje natyrale të ujerave nëntokësore, te cilat mund te jene te lokalizuara ne vende te caktuara, ose te shperndara ne nje zone te gjere ose jo. Dalja shfaqet aty ku vija pjezometrike e ujerave nentokesore prët vijen e tokës.

Klasifikimi i burimeve :

- Burimet ne kulm


Emertohen ne kete menyre sepse shfaqen ne kuota te larta te njejte me formacionin shkembor :



- Burime ne dentrite


Keto lloj burime shfaqen kur ujerat depertojne mbi material te copetuar shkembi ose mbi nje shtrese aluvionale e cila eshte e vendosur mbi nje shtrese te

papershkueshm, e cila percakton edhe planin e rrjedhjes se ujerave. Per te realizuar nje kaptazh sa me korekt duhet te percaktohet shtrati i papershkueshem.




- Burime ne çarje

Jane burime te cilat shfaqen nga te çara pak a shume te medha neper shkembinj, te shkaktuara nga fenomene erozioni. Zakonisht jane prezente ne formacione gelqerore. Ujerat e shiut depertojne brenda ketyre çarjeve duke mbushur rrjetin e ketyre kanaleve deri ne nje nivel te caktuar, e cila ndryshon ne varesi te rreshjeve atmosferike sezonale.




- Burime në shtresë

Keto burime shfaqen kur orografia e terrenit eshte e tille qe nxjerr të zbuluar ujerat nentokesor i cili eshte i vendosur mbi nje shtrat të papërshkrueshem :



- Burime në sinklinal

Keto burime shfaqen kur nje shtrese terreni e pershkueshme jane te vendosura mbi nje shtrese te papershkueshme ne forme kurore.



- Burime me dalje te niveleve idrostatike



Burimet ujore jane dalje natyrale të jerave nëntokësore, te cilat mund te jene te lokalizuara ne vende te caktuara, ose te shperndara ne nje zone te gjere ose jo. Dalja shfaqet aty ku vija pjezometrike e ujerave nentokesore prët vijen e tokës.

Klasifikimi i burimeve :

- Burimet ne kulm


Emertohen ne kete menyre sepse shfaqen ne kuota te larta te njejte me formacionin shkembor :



- Burime ne dentrite


Keto lloj burime shfaqen kur ujerat depertojne mbi material te copetuar shkembu ose mbi nje shtrese aluvionale e cila eshte e vendosur mbi nje shtrese te

papershkueshm, e cila percakton edhe planin e rrjedhjes se ujerave. Per te realizuar nje kaptazh sa me korekt duhet te percaktohet shtrati i papershkueshem.




- Burime ne çarje

Jane burime te cilat shfaqen nga te çara pak a shume te medha neper shkembinj, te shkaktuara nga fenomene erozioni. Zakonisht jane prezente ne formacione gelqerore. Ujerat e shiut depertojne brenda ketyre çarjeve duke mbushur rrjetin e ketyre kanaleve deri ne nje nivel te caktuar, e cila ndryshon ne varesi te rreshjeve atmosferike sezonale.



- Burime në shtresë


Keto burime shfaqen kur orografia e terrenit eshte e tille qe nxjerr të zbuluar ujerat nentokesor i cili eshte i vendosur mbi nje shtrat të papërshkrueshem :



- Burime në sinklinal



Keto burime shfaqen kur nje shtrese terreni e pershkueshme jane te vendosura mbi nje shtrese te papershkueshme ne forme kurore.




- Burime me dalje te niveleve idrostatike



Nga dalja e ujerave, nga thellesia e gjeresia e shtreses ujëmbajtëse zgjidhet skema më e pershtatshme per ndertimin e vepres se marrjes. **Per ujera nentokesore me thellesi te vogla 3-7m nga siperfaqja e tokes ndertohen ujemarres horizontal.**

Si rregull duhet fillimisht qe te zbulohet burimi, duke larguar masivin shkembor te copetuar. Me tu gjendur burimi duhet qe vepra e marrjes te mos zvogeloje ose te rris kuoten e daljes se burimit sepse ekziston rreziku qe burimi te zhduket neper dentrite ose te zhvillohet ne nje tjeter vend.



Kaptazhi do te jete i organizuar ne dy dhoma :

-Dhoma e pare e quajtur dhoma e grumbullimit ose e sedimentimit, ne te cilen rrjedha ka nje shpejtesi shume te vogel 0.1-0.2m/sek me qellim sedimentimin e materialit te ngurt.

-Permes nje kaperderdhese uji do te kaloje ne dhomen e marrjes se ujit. Kaperderdhese do te perdoret edhe per matjen e prurjes. Tubi i thithjes e pajisur me kosh thithje do te pozicionohet me aks 0.5m nga fundi i vaskes me qellim mos hyrjen e materialit te depozituar. Gjithashtu duhet te sigurohemi qe niveli i ujit ne dhome te mos bjere nen nivelin e tubit te thithjes me qellim mos hyrjen e ajrit.

Llogaritjet hidraulike per vepren e kaptazhit :

- **Llogaritja e trashesise se shtreses se drenazhit**

Nisur nga relacioni hidrogjeologjik Burimi del në kontakt të gëlqerorëve të kretakut të sipërm me flishin e jurastik – mastriktianit. me prurje të ndryshueshme nga 5 l/s në kohën ujëpakët (sipas të dhënave) deri 70 l/s në kohë reshjesh. Ne relacion specifikohen kushtet per ndertimin e vepres se marrjes :

- Kaptazhimi i burimit e rekomandojmë të bëhet nëpërmjet hapjes së një transheje me gjerësi sa fronti i daljes rreth 10 m dhe thellësi rreth 2 m. në mënyrë që uji të bie lirshëm në transhe pa pengesa. Pastaj ndërtojmë një mur prej guri me një perde të fortë betoni për të eliminuar rrjedhjet anësore.

Persa me siper pranojme materialin drenazhues si perzierje çakell-zhavorr me nje koeficient filtrimi  $K=10^{-2} - 10^{-4}$  m/sek

Nisur nga ligji Darcy :

$$Q = K \cdot I \cdot A$$

Ku I gradienti hidraulik

A : seksioni terthor

Seksioni terthor llogaritet sa sipërfaqja terthore në kontakt me rrjedhën  $A=7.35m^2$

Gradienti hidraulik llogaritet si rënie e vlerës së nivelit pjezometrik për distancën L

$$I = \frac{\Delta h}{L} = \frac{2}{L}$$

Po të zëvendësojmë në ekuacionin Darcy kemi si më poshtë :

$$0.07 \frac{m^3}{sek} = 10^{-4} \cdot \frac{2}{L} \cdot 7.35$$

$$0.07 \frac{m^3}{sek} = \frac{0.147}{L} \Rightarrow L = 2.1ml$$

Trashësia e shtresës së drenazhit me qellim marrjen e prurjes së projektit në rast përdorimi të një materiali me koeficient filtrimi të lartë nuk duhet të jetë më shumë se 2m. Për çdo rast tjetër, duhet të realizohen llogaritjet faktike.

#### - Llogaritja kapërdhësit në kaptazh

Kapërdhësi i instaluar do të jetë me prag të gjërë, zgjedhim gjërësin  $B=1m$ , me qellim përcjelljen e prurjes  $Q=70 l/sek$  :

$$Q = 0,385 \cdot b \cdot \sqrt{2 \cdot g \cdot H^{3/2}} = 1,705 \cdot b \cdot H^{3/2}$$

**Q**  m<sup>3</sup>/s

**b**  m

**H**  m

Le cifre decimali devono essere separate dal punto e non dalla virgola.  
Prima del punto occorre sempre digitare una cifra (ad es: 0.2).

**Q** = [m<sup>3</sup>/s]: portata del getto

**b** = [m]: larghezza della soglia

**L** = [m]: lunghezza della soglia

**H** = [m]: altezza del fluido indisturbato a monte della soglia (carico)

**h** =  $2 \cdot H/3$  [m]: altezza della vena fluida sopra la soglia

Sipas dimensioneve të kapërdhësit dhe nivelit të ujit për kapërdhësi përdorim gjërat që kemi të bëjmë me një kapërdhës me prag të gjërë, në momentin që plotësohet kushti :

$$\delta = (2-3) \cdot H$$

Për kapërdhës me prag të gjërë :

$$\delta = 2 \cdot H = 2 \cdot 0.12 = 0.24m$$

**Llogarisim tubacionin e thithjes :**

Ky llogaritet si hundez e brendshme cilindrike me formule :

$$Q = \mu \cdot S \cdot \sqrt{2gH}$$


**Q**  m³/s

**h**  m

**D**  m

Devono essere separate dal punto e non dalla virgola.  
Occorre sempre digitare una cifra (ad es: 0.2).

I valori indicati dall'asterisco sono obbligatori per il funzionamento del calcolo



$Q = \mu S \sqrt{2gh}$

**Legenda**

**Q** = Portata effluente dalla luce














**h** = distanza tra il baricentro della luce e il pelo libero

**D** = Diametro della condotta

Shtojme vleres se h edhe humbjet e ngarkeses si pasoje te humbjeve hidraulike lokale :

$$h_v = \sum \zeta \cdot \frac{V^2}{2g}$$

Nga skema hidraulike kemi qe koefiçentit të humbjeve te vendit  $\sum \zeta$  për çdo segment. Keto vlera do ti percaktojme duke u bazuar ne tabelat e ndertuara per elementet e tille. Tabela si me poshte :

	pipe bend 90° $r > 4 d \zeta = 0.2$ $r = d \zeta = 0.4$ pipe bend 180° $\zeta = 2 \times \zeta_{90^\circ}$										
	sharp-edged $\zeta = 0.5$										
	rounded off $\zeta = 0.25$										
	Inlet nozzle $\zeta = 0.05$										
	Inlet cone $\zeta = 0.2$										
	Straight pipe $\zeta = 3$										
	Branch $\zeta = 0.1$ (straight through) $\zeta = 0.9$ (branch)										
	T-pipe $\zeta = 0.4$ (straight through) $\zeta = 0.2$ (incoming branch)										
	Sudden increase in area <table border="1"> <thead> <tr> <th><math>d_2/d_1</math></th> <th>1.5</th> <th>2</th> <th>2.5</th> <th>10</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td><math>\zeta</math></td> <td>0.3</td> <td>0.6</td> <td>0.7</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table>	$d_2/d_1$	1.5	2	2.5	10	$\zeta$	0.3	0.6	0.7	1
$d_2/d_1$	1.5	2	2.5	10							
$\zeta$	0.3	0.6	0.7	1							
	Sudden decrease in area <table border="1"> <thead> <tr> <th><math>d_2/d_1</math></th> <th>1</th> <th>0.8</th> <th>0.6</th> <th>0.4</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td><math>\zeta</math></td> <td>0</td> <td>0.2</td> <td>0.3</td> <td>0.4</td> </tr> </tbody> </table>	$d_2/d_1$	1	0.8	0.6	0.4	$\zeta$	0	0.2	0.3	0.4
$d_2/d_1$	1	0.8	0.6	0.4							
$\zeta$	0	0.2	0.3	0.4							
	Non-return valve (fully open) flap $\zeta = 1 - 0.4$ seating $\zeta = 8 - 1$ ball $\zeta = 2 - 0.5$ Maker's catalogue should be consulted for exact values										
	Valve (fully open) gate valve $\zeta = 0.2$ seated valve $\zeta = 3$ butterfly valve $\zeta = 0.2$ ball cock $\zeta = 0.1$ Maker's catalogue should be consulted for exact values										
	diffusers $\zeta = \zeta^1 [1 - (d_1/d_2)^2]$ <table border="1"> <thead> <tr> <th><math>\phi</math></th> <th>0°</th> <th>15°</th> <th>30°</th> <th>45°</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td><math>\zeta^1</math></td> <td>0</td> <td>0.2</td> <td>0.7</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table>	$\phi$	0°	15°	30°	45°	$\zeta^1$	0	0.2	0.7	1
$\phi$	0°	15°	30°	45°							
$\zeta^1$	0	0.2	0.7	1							

Vlersojme rastin e llogaritjes se  $\sum \zeta$  :

Nga skema kemi :

1 thithje me tub rakord drejtkendesh  $\zeta = 3$

1 Saraçineskë flutur plotesisht e hapur DN-250mm  $\zeta = 0.2$

$$\sum \zeta = 3.2$$

$$h_v = \sum \zeta \cdot \frac{V^2}{2g} = 3.2 \cdot \frac{1.43^2}{2 \cdot 9.8} = 0.33m$$

Me kete llogaritje niveli i ujit maksimal llogaritet te shkoje ne vlere :

$$h=0.33+0.43=0.76m$$

Ne kete menyre kemi percaktuar kuoten maksimale te kreshtes se kaperderdhesit +1739.63m

## 8.1 TUBACION TRANSMETIMI KAPTAZH – REZERVUAR MAQELLARE

Tubacioni i transmetimit sherben per transportin ne rrugen me te shkurter te mundshme nga vepra e marrjes deri ne rezervuarin Maqellarë. Nga pikepamja hidraulike ai paraqet nje sistem hidraulik tubacioni me presion dhe llogaritja hidraulike per dimensionimin e tyre behet duke perdorur marredheniet e njohura per llogaritjen e tubacioneve me presion. Ne zgjedhjen e tipit te tubacionit eshte marre ne konsiderate faktoret qe vijojne :

- Pesha dhe lehtësia ne vendosjen ne terren e tij
- Kerkesat e mirembajtjes dhe jetegjatesia e pritshme e tij
- Natyra e terrenit ku do te kaloje aksi i tubacionit
- Klima dhe lloji i tokes

Gjate permasimit te tubacionit te celikut jane zgjidhur dy parametra te rendesishem :

- Diametri eshte perzgjedhur ne menyre te tille qe te mundesoje transportin dhe prurjes dhe ruajtjen e nje ngarkese minimale piezometrike 4-5m
